Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

**Zyra për Informim**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2762 Nr. i faq/Br.str/No.pg 47
Data/Datum/Date 29/ 9/ 2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

| | |
|---|---|
| **Data/Date:** | 28.09.2022 |
| **Nga/Od/From** | Grupi punues |
| **Për/Za/To:** | Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit |
| **CC** | Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, Defrim Kafexhiu |
| **Tema/Subjekat/Subject** | Raporti për konsultimin publik për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave |

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

## Ecuria e procesit të konsultimit publik për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave

Kryetari i Komunës, më 28 korrik ka marrë vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Planin e Menaxhimit të Mbeturinave

Grupi Punues për hartimin e Planin e Menaxhimit të Mbeturinave
, në këtë përbërje:

1. Bjondina Ramaj-Fazliu –kryesuese
2. Përparim Krasniqi –anëtar
3. Afrim Limani – anëtar
4. Ilir Haxhijaha–anëtar
5. Përfaqësues nga KRM "Ekoregjioni"- anëtar
6. Përfaqësues nga Kompania "Ekodrinia", anëtar

Grupi punues ka për detyrë që të bëj rishikimin e planit komunal për mbeturina n mbeturina në komunën e Rahovecit.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime rreshtazi, duke bërë rishikimin e planit komunal për mbeturina në komunën e Rahovecit.

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave u vu në konsultim publik më 11 gusht 2022 deri më 11 shtator 2022 ashtu siç parasheh Udhëzimi për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike ndërsa konsultimi publik u parapa të mbahej më 25 gusht 2022, mirëpo për shkak të grevës në administratë u mbajt më 29 gusht 2022.

Njoftimi: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-PUBLIK-PLANI-I-MENAXHIMIT-TE-MBETURINAVE.pdf

Dokumenti kryesor: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/plane-konsultime-publike/

Procesverbali i publikuar: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/09/Procesverbal-Plani-i-Menaxhimit-te-Mbeturinave-2021-2025.pdf

Platforma Qeveritare për Konsultime Publike: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41493

## Konsultimi Publik

**Konsultimi Publik për Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave u mbajte më: 29.8.2022 në Sallen e Kuvendit Komunal Rahovec, me fillim nga ora 13:30**

| Metodat e konsultimit | Data/ Kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve | Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa/ sugjerime |
|---|---|---|---|
| 1. **Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me pjesëmarrës nga lagjet urbane dhe këshillat e fshatrave si dhe me përfaqësues të kompanive të mirëmbatjes që veprojnë në komunën e Rahovecit** | 29.08.2022<br>1 orë | 12 pjesëmarrës<br>0 femra | 8 pjesëmarrës kanë parashtruar pyetje |
| **Publikimi në ueb faqe / platforma elektonike** | 14 ditë para dëgjimit publik | | Asnjë koment nuk kemi marrë |

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuara dhe të refuzuara.

| Kërkesat / Sugjerimet / Komentet | Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|
| *Elmi Popaj, përfaqësues i fshatit Fortesë: desha të ju pyes se a janë te përfshirë te gjithë qytetarët në mbledhjen e mbeturinave duke e ditur se ende ka persona që hedhin mbeturina vend e pa vend. Poashtu kërkoj një përfshirje më të madhe të inspektoratit sepse ka hudhje të mbeturinave kudo nga ana e qytetarëve duke përfshirë edhe hudhjen e mbeturinave te lumi në mes të fshatit.* | I pranuar | **Perparim Krasniqi**, *drejtor i shërbimeve publike:* Përveç inkasimit dhe zgjerimit kemi pasur disa raste në ankesë për çështjen e barazimit për shkak të ndërrimit të kompanisë për mbledhjen e mbeturinave, ajo qeshtje është përfunduar, po ashtu po shpresojmë te bëjmë zgjidhje në vjeshte për pastrimin e lumit duke e ditur se ka vegjetacion dhe ka filluar të ngushtohet edhe për shkak të hudhjeve ilegale të mbetjeve inerte. |
| *Selajdin Gashi, kryetar i këshillit te fshatit Çifllak:kërkoj angazhimin e inspektoratit duke mbrojtur pjesën e parcelave përreth Drinit të Bardhë për shkak të pakujdesisë dhe hudhje të mbeturinave ani pse komuna çdo vit ka* | I pranuar | **Perparim Krasniqi**, *drejtor i shërbimeve publike:* Çdo vit Komuna e Rahovecit ka bërë pastrimin dhe ndërgjegjësimin për këtë pjesë ku ju jeni duke folur, po ashtu bëjë thirrje tek ju dhe çdo qytetar që ka informatë për hedhjen e mbeturinave të lajmërohet në inspektorat. Tek qeshtja e përgjegjësisë si dhe te hedhja e lëngut, komuna jonë sidomos gjatë sezonës verore duhet të përdorin kompostimin ku vetëm vitin e kaluar |

| | | |
|---|---|---|
| *eliminuar këto deponi ilegale.*<br>**Po ashtu kërkoj një përgjegjshmëri më të madhe nga ana e kompanisë që mbledh mbeturina që lëngu i cili krijohet gjatë mbledhjes së këtyre mbeturinave po derdhen nga mjetet qe transportojnë këto mbetje. Kërkojmë një listë të atyre qe nuk po paguajnë mbeturina qe te evidentojmë kush po hedhë mbeturina në rrugë** | | komuna jonë ka bërë shpërndarjen e 300 komposterëve për trajtimin e produkteve bimore të lëngshme |
| ***Naser Dula, profesor i muzikës: Ju përshëndes të gjithëve, ju përgëzojm për punën e deritanishme sa i përket menaxhimit komuna e Rahovecit është për çdo lavdat lidhur me kompanit që operojnë për mbledhjen e mbeturinave*** | | **Perparim Krasniqi,** *drejtor i shërbimeve publike:* Faleminderit profesor, poashtu po e shfrytëzoj rastin të ju njoftoj se komuna e Rahovecit ka fituar donacione lidhur me organizimin e aktiviteve për mjedis të pastër, ka bërë shpërndarjen e 6500 kontejnerave 120L si dhe 300 kontejner 1m3. |
| *Kujtim Sopjani:* ***unë po kërkoj që të përfshihen të gjithë qytetarët në regjistrim sepse kohë pas kohe po krijohen mbeturina në vende ku nuk duhen*** | I pranuar | Perparim Krasniqi, *drejtor i shërbimeve publike* Komuna e Rahovecit është e gatshme që në bashkëpunim me kompanitë të bëjmë përpjekje për ndërgjegjësimin dhe regjistrimin e të gjithë atyre që bëjnë hudhjen e mbeturinave. |
| ***Avni Morina, drejtor i arsimit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmt, kërkoj nga prezentuesi i planit që të n'a informojë më shumë për planet e reja.*** | I pranuar | **Perparim Krasniqi:** ky plan tregon objektivin, ndarjen në burim, deri te riciklimi poashtu edhe pritet në vitet ne vazhdim edhe |

| | | |
|---|---|---|
| | | procedura për inaksimin e mjeteve të taksës për mbeturina nga komuna. |
| | | |
| *Afrim Krasniqi, përfaqësues i fshatit Pastasel: Unë kërkoj qe të merren më shumë masa për hedhjen ilegale të mbeturinave inerte sidomos në kanale të ndryshme* | I pranuar | **Perparim Krasniqi,** *drejtor i shërbimeve publike* Komuna e Rahovecit respektivisht drejtoria për Punë Inspektuese vazhdimisht është e fokusuar që ndjek penalisht duke gjobitur të gjithë hudhësit e mbeturinave inerte në vende ku dëmtojnë ambientin dhe krijojnë vështirësi të ndryshme. |
| **Ismet Kastrati,** *përfaqësues i fshatit Zatriq*: **Kërkoj që të largohen inertet dhe sa i përket menaxhimit jam shumë i knaqur me shërbimet e kompanisë.** | | **Perparim Krasniqi,** *drejtor i shërbimeve publike*- faleminderit shumë! |

**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

1. Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit të Menaxhimit të Mbeturinave
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik
4. Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Rahovec, shtator 2022

Blerta Gashi

Zyrtare për Informim

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR - RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 01 Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 2210 Nr. i faq/Br.str/No pg 384
Data/Datum/Date 31 / 5 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e Grupit Punues për rishikimin e planit komunal lokal për mbeturina në Komunën e Rahovecit**

1. **Caktohet** Grupi Punues për rishikimin e planit komunal lokal për mbeturina në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
   **1.1** Bjondina Ramaj-Fazliu, kryesuese
   **1.2** Përparim Krasniqi, anëtar
   **1.3** Afrim Limani, anëtar
   **1.4** Ilir Haxhijaha, anëtar
   **1.5** Përfaqësues nga KRM "Ekoregjioni", anëtar
   **1.6** Përfaqësues nga Kompania "Ekodrinia", anëtar

2. Grupi punues ka për detyrë që të bëjë rishikimin e planit komunal lokal për mbeturina në Komunën e Rahovecit.

3. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

4. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Obligohet grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Grupit Punues dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Anëtarëve të Grupit Punues,*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe*
- *Arkivit*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Komuna e Rahovecit**
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2588 Nr. i faq/Br.str/No.pg 30
Data/Datum/Date 11/8/2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për hartimin e Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.3.2017 dhe Nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

# NJOFTIM PUBLIK

**Lidhur me konsultimin publik për Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave**

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **11.8.2022** deri me datën: **11.9.2022**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **25.8.2022**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit e cila gjendet në objektin e ri të administratës komunale, me fillim në ora **10:00**.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën **10.9.2022** në ora **16:00**, tek zyrtarët: bjondina.ramaj@rks-gov.net ; Perparim.Krasniqi@rks-gov.net , Blerta.Gashi@rks-gov.net; dhe Skender.Hamza@rks-gov.net

Për më shumë detaje, rreth **Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave**, mund të gjeni në vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqe zyrtare: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/

Platforma për Konsultime Publike: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/

Facebook: https://www.facebook.com/rahoveckomuna

Blerta Gashi

Zyrtar per Informim

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
**Komuna e Rahovecit**
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Lista e nënshkrimëve e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për **Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave**

| Nr | Emri | Mbiemri | Vendi-Institucioni | Nr. Tel | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | KUSHTRIM | ZEKA | KT PATAQA i POSHTË | | |
| 2 | Elhami | Zhuniqi | Fortesë | | |
| 3 | ELMI | POPAJ | FORTESË | | |
| 4 | Sebajdin | Gashi | Qifllak | | |
| 5 | KUJTIM | SOPIANI | DOBIDOL | | |
| 6 | ISMET | KASTRATI | ZHTRIQ | | |
| 7 | TEKI | MUSTAFA | RAHOVEC LAGJA 2 | | |
| 8 | Afrim | Krasniqi | Pastaselle | | |
| 9 | Avdyl | Hoti | Eko Dimia | | |
| 10 | QAZIM | Hoti | Eko Dimia | | |
| 11 | MELTOR | DURGUTI | EKO-REGJIONI | | |
| 12 | Naser | Duta | SHKOLLA MUZIKË | | |
| 13 | | | | | |
| 14 | | | | | |
| 15 | | | | | |
| 16 | | | | | |
| 17 | | | | | |
| 18 | | | | | |
| 19 | | | | | |
| 20 | | | | | |

Përgatiti: Bleta Gashi

Nënshkrimi:

Data: 29.08.2022

Lista e nënshkrimëve të zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për **Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave**

| Nr | Emri | Mbiemri | Pozita | Nr. Tel | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PËRPARIM | KRASNIQI | DSHP | | |
| 2 | Blerta | Gashi | ZIP | | |
| 3 | Dielza | Ganta | DPSHS | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |
| 7 | | | | | |
| 8 | | | | | |
| 9 | | | | | |
| 10 | | | | | |

Përgatiti: Blerta Gërxhaliu

Nënshkrimi:

Data: 29.08.2022